REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 8730 **Prot.** **Lushnje, më** 14.09 **2026**

R E L A C I O N
KËSHILLIT BASHKIAK
PËR MIRATIMIN E INVESTIMIT ME OBJEKT: REHABILITIMI I KANALIT UJITËS U-2-8/1,U-2-8/2,U-2-8/2-1 ,NË KARBUNARË, RAJONI 5, BASHKIA LUSHNJË

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltarë!

Me **Vendimin nr. 668, datë 02.09.2026, të Këshillit të Ministrave**, Bashkia Lushnjë ka përfituar financim për realizimin e investimit me objekt **"Rehabilitimi i kanalit ujitës U-2-8/1,U-2-8/2,U-2-8/2-1 ,në Karbunarë, Rajoni 5, Bashkia Lushnjë"**.
Në vijim të këtij vendimi dhe me qëllim vijimin e procedurave për realizimin e investimit, paraqitet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit Bashkiak investimi i sipërpërmendur.
Ky investim synon rehabilitimin e kanalit ujitës dhe përmirësimin e funksionimit të infrastrukturës së ujitjes në zonën e Karbunarës, duke mundësuar ofrimin e një shërbimi më të mirë për sipërfaqet bujqësore dhe fermerët që përfitojnë nga ky sistem.
Për sa më sipër, kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i objektit të investimit **"Rehabilitimi i kanalit ujitës në Karbunarë, Rajoni 5, Bashkia Lushnjë"**, si dhe vijimi i procedurave përkatëse për zbatimin e tij.
Vlera totale e investimit është 47,211,240 lekë, e ndarë sipas Vendimit nr **668, datë 02.09.2026** , si më poshtë:

Viti i parë, 2026: 9,538,690 lekë;
Viti i dytë 2027: 13,552,496 lekë;
Viti i tretë 2028: 17,094,089 lekë.

Shuma e financuar gjatë këtyre tre viteve është **40,185,275 lekë**, ndërsa **pjesa e mbetur prej 7,025,965 lekësh do të financohet në vitet në vijim** nga fondet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Për Ndërmarrjen e Pasurisë Publike
Elson Zeka
Renis Muco

KRYETARI I BASHKISË
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr. 8730/1 Prot.

Lushnje,më 14.09 2026

PROJEKT-VENDIM
NR 81 DATË 14 .09.2026

PËR MIRATIMIN E INVESTIMIT ME OBJEKT: REHABILITIMI I KANALIT UJITËS U-2-8/1,U-2-8/2,U-2-8/2-1 ,NË KARBUNARË, RAJONI 5, BASHKIA LUSHNJË

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës .09 .2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë, në mbështetje nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 shkronja "b" pika 1.6 shkronja "a" neni 27 pika 1 te Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar. Neni 1 shkronja 'b" neni 4 pika l, neni 12 pika 1 të Ligiit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit " i përditësuar . Ligji 24/2017 per Administrim e Ujitjes dhe te Kullimit ,Neni 4 pika 4, neni 6 shkronja "b" neni 7 pika 1 të Ligiit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" si dhe Vendimin nr. 668, datë 02.09.2026, të Këshillit të Ministrave :

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e investimit me objekt: **"Rehabilitimi i Kanalit Ujitës U-2-8/1, U-2-8/2, U-2-8/2-1, në Karbunarë, Rajoni 5, Bashkia Lushnjë".**
2. **Vlera totale e investimit është 47,211,240 lekë**, e ndarë sipas Vendimit nr **668, datë 02.09.2026**, si më poshtë:
   Viti i parë, 2026: 9,538,690 lekë;
   Viti i dytë 2027: 13,552,496 lekë;
   Viti i tretë 2028:17,094,089 lekë.

3. Shuma e financuar gjatë këtyre tre viteve është **40,185,275 lekë**, ndërsa **pjesa e mbetur prej 7,025,965 lekësh do të financohet në vitet në vijim**.(nga fondet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural)
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve,Ndërmarrja e Pasurisë Publike
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Ndërmarrja e Pasurisë Publike
Elson Zeka
Renis Muco

Drejtoria Juridike
Bedri Hida
P. Enejd Shamo

KRYETARE BASHKISË
Eriselda Sefa